



Prishtinë, 02 shkurt 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3146_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në e Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, ë Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Metodologjia e përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, kërkesën e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX, për përcaktimin e tarifave NEMO për periudhën 2026, 2027 dhe 2028, dega në Republikën e Kosovës, të datës 14 nëntor 2025,

në seancën e mbajtur më 02 shkurt 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** – Lista e Tarifave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës dhe;
- II. Të hyrat e lejuara të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës, për vitet përkatëse janë: 669,028 € për vitin 2026, 712,410 € për vitin 2027 dhe 835,613 € për vitin 2028.
- III. Tarifat e miratuara me këtë vendim do të aplikohen për tregun e Ditës në Avancë (një-ditë-para) dhe Tregun e Ditës së Njëjtë (ndërditor), sipas strukturës tarifore në fuqi.
- IV. Në rast se nga zbatimi i tarifave rezultojnë të hyra mbi ose nën nivelin e të hyrave të lejuara, korrigjimi dhe kompensimi përkatës do të bëhet në periudhën rregullatore pasuese, pas paraqitjes së aplikimit përkatës nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës, në përputhje me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të NEMO-s.
- V. Lista e tarifave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës, të aprovuara nga bordi i ZRRE-së, do jenë të zbatueshme gjatë vitit 2026, të cilat mund të aplikohen edhe për vitet 2027 dhe 2028 nëse nuk kemi kërkesë të përditësuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës, apo ndryshime në kostot dhe të hyra për këtë periudhë rregullative.
- VI. Struktura e tarifave të ALPEX është dhënë në tabelën e mëposhtme, dhe termet e përdorura e kanë kuptimin e njëjtë me ato që aplikohen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës:



Lista e Tarifave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun e Ditës në Avancë (një-ditë-para)	Vjetore	14,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	7,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	3,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun e Ditës në Avancë (një-ditë-para)	Ditore	0.090 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Teknike	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun e Ditës në Avancë (një-ditë-para)	Transaksion	0.020 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Tregtimit në emër të dikujt tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtari i Bursës
Tarifa për API përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për Përdorues	Vjetore	50 €	Anëtari i Bursës/Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njejtës Ditë (ndërditor)	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njejtës Ditë (ndërditor)	Ditore	0.14 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njejtës Ditë (ndërditor)	Ditore	0.04 €	Anëtari i Bursës



- VII. Tarifat duhet të publikohen në faqen zyrtare të ueb-it www.alpex.al.
- VIII. Ky vendim zbatohet për zonën ofertuese të Republikës së Kosovës deri në shqyrtimin e ardhshëm e të tarifave të ALPEX.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 14.11.2025 nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A.), dega në Republikën e Kosovës, ka pranuar kërkesën për përcaktimin e tarifave NEMO për periudhën 2026, 2027 dhe 2028, për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës dhe si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), ushtron aktivitetin e saj në zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës në kuadër të tregut të përbashkët Shqipëri–Kosovë.
- ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, ka paraqitur në ZRRE kërkesën për përcaktimin/vijimin e tarifave të NEMO-s, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës financiar dhe teknik, për periudhën rregullatore pasuese.
- Aplikimi i ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, përfshin të dhënat financiare të pesë viteve të fundit, projeksionet e periudhës 2026, 2027, 2028, strukturën e aseteve, kostot e operimit, koston e platformës, amortizimin, llogaritjen e WACC, kapitalin e punës dhe listën e tarifave të propozuara.
- ZRRE ka shqyrtuar përputhshmërinë e këtyre elementeve me metodologjinë dhe ka analizuar edhe trendet historike të kostove dhe të ardhurave. ZRRE ka shqyrtuar përmbushjen e kriterëve formale dhe përmbajtësore dhe ka vendosur hapjen e procedurës për shqyrtimin e aplikimit tarifor, në përputhje me kërkesat e Metodologjisë përkatëse.
- Në vijim të kësaj procedure, ZRRE ka zhvilluar procesin e konsultimit publik, duke publikuar “Raportin Konsultativ- Shqyrtimi i Aplikimit të ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, për Tarifat e NEMO 2026-2028” dhe aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues të ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, dhe duke ftuar palët e interesuara për paraqitjen e komenteve dhe vërejtjeve brenda afatit të përcaktuar ligjor.
- Gjatë periudhës së konsultimit publik, ZRRE nuk ka pranuar komente apo vërejtje nga palët e interesuara.
- Në mungesë të komenteve nga palët, ZRRE ka vijuar shqyrtimin e aplikimit mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, analizës së brendshme teknike dhe financiare, si dhe Raportit Konsultativ të përgatitur nga departamenti përkatës.
- Nga analiza rezulton se aktiviteti i NEMO-s në Republikën e Kosovës ndodhet ende në fazë konsolidimi, me histori të kufizuar financiare dhe operative dhe me një bazë minimale të aseteve të rregulluara (RAB), ku struktura e të hyrave dominohet nga kostot operative.



- Struktura e tarifave të aplikuara nuk paraqet rritje krahasuar me tarifat në fuqi, ndërsa parashikimet për rritjen e të hyrave lidhen kryesisht me rritjen e volumit të tregtimit të energjisë elektrike në tregjet e Ditës në Avancë (DAM) dhe Ditës së Njëjtë (IDM).
 - ZRRE vlerëson se, duke qenë se NEMO operon përmes një platforme të përbashkët tregtimi dhe klerimi për dy zona ofertimi, kostot dhe të hyrat e këtij aktiviteti duhet të trajtohen në mënyrë të konsoliduar, me qëllim sigurimin e tarifave uniforme dhe trajtimit të barabartë të pjesëmarrësve në treg.
 - Megjithëse të hyrat shfaqin trend rritës gjatë periudhës 2026–2028, kjo rritje nuk është rezultat i rritjes së tarifave, nuk buron as nga rritja e kostove për njësi, por vjen si pasojë direkte e zgjerimit të portofolit të anëtarëve të bursës, rritjes së volumit të energjisë së tregtuar në DAM dhe IDM, rritjes së aktivitetit dhe likuiditetit të tregut të organizuar.
 - Pra, rritja e të hyrave reflekton zhvillimin e tregut dhe rritjen e volumit të shitjeve në bursë, dhe jo rritje të barrës tarifore për pjesëmarrësit.
 - Në përputhje me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të NEMO-s, çdo diferencë ndërmjet të hyrave të realizuara dhe të hyrave të lejuara, mbi apo nën nivelin e rikuperimit të lejuar, do të trajtohet dhe korrigohet në periudhën rregullatore pasuese.
 - Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës për zgjatje të afatit për miratimin e Listës së tarifave të ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- IX.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- X.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- ALPEX SH.A. dega në Republikën e Kosovës,
- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A.), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.